

Formular për SYLLABUS të Lëndës EKONOMIKSI I PERSONELIT

Informatat themelore për lëndën	
Njësia akademike:	Fakulteti Ekonomik
Titulli i lëndës:	Ekonomiksi i personelit
Niveli:	BA
Statusi lëndës:	Zgjedhore
Viti i studimeve:	Viti III, Semestri VI
Numri i orëve në javë:	2+1
Vlera në kredi – ECTS:	4
Koha / lokacioni:	<i>Caktohet nga dekanati në fillim të vitit</i>
Mësimdhënësi i lëndës:	Prof.Dr.Ass.Luljeta Elezaj
Detajet kontaktuese:	Fakulteti Ekonomik, UP, , Kati VI, kabineti 78 Email: luljeta.elezaj@uni-pr.edu Konsultimet: <i>caktohen në fillim të semestrit</i>
Përshkrimi i kursit	Shumica e vendimeve strategjike në kompani përfshijnë: ndryshimin (rritjen/zvogëlimin) e numrit të punëtorëve, ngritjen e aftësive të tyre për punë (rritjen e produktivitetit), ndryshimin (rritjen/zvogëlimin) e numri të punëtorëve me një nivel të caktuar arsimor apo moshë të caktuar, futjen e insentivave për të ngritur motivimin dhe rrjedhimisht produktivitetin e punëtorëve, ndryshimin e formës dhe/apo nivelit të pagës etj. Të gjitha temat në kuadër të këtij kursi trajtohen duke aplikuar teorinë rigoroze të ekonomiksit, e cila mundëson që edhe çështjet e resurseve humane/personelit të analizohen duke aplikuar teorinë dhe premiset e ekonomiksit si: maksimizimi i dobisë apo profitit, insentivat dhe produktiviteti etj.
Qëllimet e lëndës:	Ky kurs bazik nga 'Ekonomiksi i Personelit' ka për qëllim tu ofrojë studentëve: (i) kornizën teorike për analizimin e çështjeve të resurseve humane/personelit në organizata dhe institucione të ndryshme dhe (ii) disa aspekte të politikave që lidhen me menaxhimin dhe optimalizimin e përdorimit të resurseve humane/personelit.

Rezultatet e pritura të nxënies:	Pas përfundimit të këtij kursi studentët do të jetë në gjendje që: 1. Të formojnë opinionin e tyre në lidhje me anët pozitive dhe negative mbi qasjen ekonomike ndaj resurseve humane/personelit, 2. Të demonstrojnë aftësi për të përdorur modelet e ndryshme ekonomike për të analizuar situatat e ndryshme që paraqiten lidhur me resurset humane/personelin, 3. Të vlerësojnë në mënyrë kritike efektin e politikave të ndryshme në sjelljen e resurseve humane/personelit në kuadër të organizatës.		
Kontributi në ngarkesën e studentit			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithsej
Ligjërata	2	13	26
Ushtrime	1	15	15
Testet	2	2	4
Zhvillimi i punimit seminarik	4	3	12
Punë e pavarur e studentit (në bibliotekë, shtëpi)			40
Testi Final	3	1	3
Totali			100
Metodologjia e mësimdhënies:			
	Në kuadër të këtij kursi, studentët kalojnë 30 orë mësimore në kontakt me mësimdhënësin në ligjërata dhe seminare/diskutime (15 javë x 2 orë). Orët e tjera të ngarkesës mësimore në kuadër të këtij kursi studentët duhet t'i kalojnë në studime të pavarura, përgatitjen e seminareve, eseve/punimeve dhe provimin përfundimtar. Mësimi organizohet ashtu që tri javë mbahen nga dy orë ligjërata sipas orarit të paraparë, ndërsa çdo të katërtën javë organizohen seminare (diskutime) rreth një teme të caktuar për të cilën studentët njoftohen paraprakisht. Studentët janë të obliguar që temën e seminarit ta përgatisin paraprakisht për ta diskutuar në orën e seminareve. Studentët inkurajohen që të përgatisin ‘studime rasti’ (case study) për tema të caktuara që diskutohen në kuadër të këtij kursi. Këto studime rasti dhe pjesëmarrja aktive në seminare/diskutime kontribuojnë në vlerësimin përfundimtar nga ky kurs.		

Metodat e vlerësimit:	Në mënyrë që të ketë një vlerësim sa më të drejtë të punës së studentëve gjatë gjithë semestrit, nota përfundimtare në këtë kurs do të jetë rezultat i: (i) aktivitetit të treguar gjatë ligjëratave dhe seminareve 20% (ii) një punimi me shkrim mbi një temë të caktuar 40% (iii) dhe provimit përfundimtar 40% (i) Aktiviteti në ligjëratat dhe posaçërisht në seminare nënkupton përgatitjen e pyetjeve për seminare që diskutohen çdo të katërtën javë (në gjithsej 4 seminare). Studentët i marrin pyetjet për seminare një javë përpara dhe pasi të ligjërohen temat përkatëse që diskutohen në seminar. (ii) Punimi me shkrim duhet të përmbajë maksimum 1,500 fjalë dhe duhet të punohet mbi një temë në kuadër të këtij kursi. Pyetjet që diskutohen në seminare mund të jenë tema të mundshme për përgatitjen e punimit me shkrim. Punimi mund të jetë gjithashtu edhe analizë e politikave të personelit të një kompanie (format e pagesës, incentivat, politikat e marrjes në punë dhe largimit nga puna, format e trajnimit etj.). Për të marrë notë kaluese punimi duhet të bazohet në teorinë e diskutuar në këtë kurs dhe të ofrojë një qasje kritike të temës që trajton. Në javët e para të kursit studentët do marrin një shembull të një punimi për ta përdorur si mostër se si duhet përgatitur punimi, si duhet të jetë formati i punimi, mënyra e citimit të literaturës, prezantimit të tabelave dhe grafikoneve etj. Punimi duhet të dorëzohet më së largu në javën e fundit të ligjëratave. (iii) Në provimin përfundimtar (sipas afatit të paraparë nga Fakulteti) studentët përgjigjen me shkrim në 2 nga 4 pyetjet e parashtruara. Përgjigjet duhet të jenë të qarta dhe të ofrojnë vështrim kritik të temës që trajtojnë. Provimi përfundimtar zgjatë 60 minuta. Gjatë vlerësimit të punimit si dhe të provimin
------------------------------	--

	përfundimtar do të merren parasysh, përveç tjerash, edhe këto aspekte: - interpretimi i temës, - thellësia e të kuptuarit të temës, - shfrytëzimi i literaturës, - evaluimi dhe sinteza e evidencës, - analizat kritike dhe logjika e ndërtimit të argumentit.
Literatura	
Literatura bazë:	Edward P. Lazear (1998): <i>Personnel Economics for Managers</i> ; Wiley & Sons, Inc., New York, NY
Literatura shtesë:	Ehrenberg, R. and Smith, R. (2003): <i>Modern labor economics: Theory and public policy</i> ; 8th edition, Addison Wesley, Boston
Plani i mësimi	
Java	Ligjërata që do të zhvillohet
Java e parë:	Hyrje në ekonomiksin e personelit
Java e dytë:	Vendosja e standardeve për punësim
Java e tretë:	Punësimi i personit të duhur
Java e katërt:	Seminari 1
Java e pestë:	Produktiviteti i punës së punëtorit
Java e gjashtë:	Paga variabile dhe fikse
Java e shtatë:	Teoria e kapitalit njerëzor
Java e tetë:	Seminari 2
Java e nëntë:	Qarkullimi/lëvizja e punëtorëve, pushimi nga puna dhe blerja e punëtorit
Java e dhjetë:	Promovimi si motivim
Java e njëmbëdhjetë:	Politikat industriale
Java e dymbëdhjetë:	Seminari 3
Java e trembëdhjetë:	Incentivat bazuar në senioritet, kompenzimi jomonetar dhe benefitet
Java e katërbëdhjetë:	Vlerësimi i punëtorëve dhe fuqizimi i punëtorëve brenda firmës
Java e pesëmbëdhjetë:	Seminari 4
Politikat akademike dhe kodi i sjelljes	
Pjesëmarrja në ligjërata dhe ushtrime është e obligueshme. Studentët inkurajohen që të kërkojnë sqarime gjatë ligjëratave dhe ushtrimeve. Mësimdhënësi do të jetë në dispozicion për sqarime shtesë dhe konsultime të studentëve. Studentët kanë për obligim që pas çdo ligjërate të lexojnë së paku literaturën që ju është caktuar dhe të kryejnë detyrat dhe esetë që do t'u jepen. Studentët nuk janë të obliguar tu nënshtrohen vlerësimeve gjatë semestrit. Studentet inkurajohen të përcjellin diskutimet publike dhe të hapin diskutime gjatë ligjëratave dhe ushtrimeve lidhur me to. Studenti duhet të jetë të respektojë institucionin dhe rregullat akademike, orarin e ligjëratave	

dhe ushtrimeve, si dhe të jetë i angazhuar gjatë zhvillimit të orës mësimore. Është e obligueshme posedimi i ID-së në teste dhe provim. Gjatë hartimit të punimeve seminarike, studenti duhet tu përmbahet udhëzimeve të dhëna nga mësimdhënësi lidhur me rregullat akademike për realizimin e hulumtimit.